



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**BASHKIA DIMAL**  
**NJËSIA E PROKURIMIT**

Nr. \_\_\_\_\_ prot.

Urë Vajguore, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ . 2024

**PROCES-VERBAL I ARGUMENTIMIT DHE MIRATIMIT TE KRITEREVE PËR  
KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**Tipi i kontratës - PUNË**

**OBJEKTI I PROKURIMIT:** “Ndërtim kanalesh vaditës fshati Goriçan”.

**Fondi limit: 38,429,776** (tridhjetë e tetë milion e katërqind e njëzetë e nëntë mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e shtatë) lekë pa tvsh, vënë në dispozicion nga Buxheti i shtetit.

Njësia e Prokurimit për procedurën në fjalë vendos që lloji i procedurës së prokurimit të jetë:  
**Procedurë e Hapur, pune.**

**Arsyeja e përdorimit të procedurës – Procedur e hapur pasi vlera e fondit limit është  
ndermjet kufirit të ulët dhe të lartë monetar,**

• ***Kriteret e përgjithshme të pranimit janë standarte dhe nuk duhet të ndryshohen nga  
Autoritetet Kontraktore.***

**Argumentimi:** Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Dimal (Njesia e prokurimit) ka hartuar proces-verbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT**

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë veprë penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda

Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo veprë penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;

d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;

dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;

e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;

gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.

i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojces 8.

Në rast të bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

### **Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.**

Në çdo rast, Autoriteti/Enti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një Bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
  
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit/entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e

nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

## **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

### **1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8;*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*
- c. *Formulari Ofertës, sipas Shtojcës 1.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 7, gërma “ç” (sipas Shtojcës 1 të DST).

Kërkesa për Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit bazohet në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 82 si dhe në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni II, Neni 26.

### **2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

#### **2.1 Kapaciteti Ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë/ Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:**

2.1.1 Tek objekti i ekstratit të leshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit të jete pasqyruar si objekt i veprimtarisë së tyre objekt i prokurimit.

2.1.2 Referuar pikës 1 të shtojcës 7, kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

#### **2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1** Kopje të çertifikuara të bilanceve të 3(*tre*) viteve të fundit (**2021, 2022, 2023**), të paraqitura në Administratën Tatimore dhe të konfirmuara prej tyre, ku të paktën në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Nëse operatori ekonomik ofertues është në kushtet e parashikuara nga neni 41, pika “c”, e ligjit nr.10091date 5.3.2009 “Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, atëherë secili bilanc duhet të shoqërohet me akt-ekspertizën e kryer nga eksperti kontabel.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

*Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në Ligjin nr. 9920 date 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, dhe aktet nenligjore në zbatim të tij.*

*Kërkesa për paraqitjen e bilanceve është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë.*

*Shënim: Akt Ekspertiza e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, duhet të paraqitet nga O.E vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma "c" të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, ku parashikohet se: "Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël".*

**2.2.2** Kopje të deklaratave të xhiros mesatare vjetore, të realizuar nga Operatori Ekonomik ofertues gjatë 3(tre) viteve të fundit (**2021, 2022, 2023**), lëshuar nga Administrata Tatimore, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jete jo më e vogël se vlera e fondit limit të kontratës që prokurohet.

**Argumentimi:** *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.*

*Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:*

*Vlera e xhiros së kërkuar është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj. Vlera e xhiros është vendosur që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.*

*Në nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" është përcaktuar si më poshtë: Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë b) vlerën e parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;*

*Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin 9920 date 19.05.2008, "Per Procedurat Tatimore", neni 64 Deklarata Tatimore.*

**2.2.3** Vertetim te shlyerjes se detyrimeve vendore per vitin 2023 dhe 2024 në të gjitha adresat ku operatori/operatoret ekonomik ushtrojne aktivitetin e tyre sipas te dhenave perkatese te ekstraktit te QKR-se.

*Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojces Nr. 8, të DST-ve dhe në zbatim të V.K.M – së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, neni 26 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit”, pika 6 “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”, si më sipër kërkuar.*

**Argumentimi:** *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP. Nenit 26 si dhe nenit 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar dhe ne ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, ne ligjin nr.9920 date 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 3.1/a, b, c dhe neni 40, ne ligjin nr.131/2015 “Per QKB” i ndryshuar, si dhe ne ligjin nr.9723 date 03.05.2007 “Per QKR” i ndryshuar.*

*Ky kriter shërben për të garantuar AK se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, kanë kapacitetet e duhura ekonomike dhe financiare si dhe janë të përshtatshëm për të*

*kryer veprimtari profesionale. Referuar sa më sipër, Autoriteti Kontraktor gjykon se kriteri i vendosur lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të deklaratës për shlyerjen e detyrimeve vendore për vitin 2023, 2024 pranë bashkisë/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari Biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t’iu nënshtuar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.*

*Në çdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.*

### **2.3 Përvojë e suksesshme në ekzekutimin e të paktën:**

**a-** punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50 % e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

**b-** punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

**-Për të vërtetuar përvojen e mëparshme duhet të paraqiten:**

**-Nëse kontrata është realizuar me institucione shtetërore:**

- Formulari i vlerësimit (sipas shtojcës 9)i shoqëruar me:
- Kontratë punimesh;
- Situacion përfundimtar;
- Akt-kolaudimi;
- Procesverbal për marrje në dorëzim të punimeve të kryera;
- Fature Tatimore

*Për kontrata te realizuara si Bashkim Operatorësh, operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë: Kontraten e bashkimit të operatorëve ekonomikë si dhe preventivin e ndarjes së punimeve të marra përsipër nga secili operator ekonomik të deklaruar në fazën e tenderimit.*

*Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë:*

- Kontratën bazë ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor;
- si dhe Miratimi zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.

**-Nëse kontrata është realizuar me subjekte private:**

- Formulari i vlerësimit i shoqëruar me:
- Kontratë punimesh,
- Situacionin përfundimtar,
- Akt-kolaudimin,
- Faturat tatimore per cdo situacion punimesh.

Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor,operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë:

- Kontratën bazë ndërmjet Kontraktorit dhe Investitorit.

**Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura për përvojën e suksesshme e bën ofertën të kualifikueshme.**

***Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5, neni 47 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat 50 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose jo me te vogel se dyfishi i vlerës limit të objektit te prokurimit për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar. Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatoresh, operatori ekonomik ofertues, është kërkuar edhe paraqitja e kontratës së bashkimit te operateve shoqeruar me tabelën e ndarjes së punimeve, ku te cilësohen punimet që ka marrë përsiper të kryejë secili anëtar i BOE, mbështetur në parashikimet e nenit 88 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij dokumentacioni AK ka mundësi të njihet me vlerën reale të punimeve të realizuara nga ofertuesi/t, mbi bazën e një kontrate të realizuar si BOE.*

*Përvoja e sukseshme si dhe vlerësimi i saj eshte hartuar duke iu referuar Nenit 77, pika 4 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” ku qartazi përcaktohet se: ”Në lidhje*

*me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.*

*AK argumenton se Puna e ngjashme është kërkesë, e cila shërben për të vlerësuar përvojën e duhur të Ofertuesve. Vlerësimi i përvojës realizohet duke paraqitur dokumentat e kërkuara të cilat vërtetojnë eksperiencën në realizimin e punëve publike të ngjashme, si dhe janë një garanci më shumë për Autoritetin Kontraktor me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi. Sqarojmë se nga praktika, gjatë fazes së vlerësimit të ofertave, AK ka hasur vështirësi në vlerësimin në mënyrë sa me të drejte të përvojës së ngjashme, pasi jo të gjitha institucionet shtetërore apo private leshojnë Formularin e Vlerësimit sipas formatit zyrtar (ku përcaktohet ndarja e përqindjeve). Në kuadër të vlerësimit të ofertave në mënyrë sa me të drejte, duhet që në rastet e BOE apo Nenkontraktim, vlerësimi i përvojës të vërtetohet me paraqitjen e kontrates së bashkëpunimit; me marrëveshjen e nenkontraktimit si dhe me aktin e miratimit të nenkontraktimit leshuar nga Institucioni. Ky dokumentacion disponohet nga çdo OE si në rastin kur ka qene pale në Bashkimin e OE ashtu dhe në rastet kur ka qene Nënkontraktor. Ky dokumentacion është lehtësisht i aksesueshëm dhe është pjesë e dosjes së zbatimit të punimeve të kontratës që duhet ta ketë çdo kompani në dosjen e saj, për rrjedhojë nuk mund të sjellë kufizim të pjesëmarrjes së OE në tender as në mënyrë direkte dhe as në mënyrë indirekte. Gjykojmë që kërkesa e mësipërme nuk është në kundërshtim me asnjë nga dispozitat ligjore që parashikon legjislacioni i prokurimit publik. Gjithashtu vendos në kushte të barabarta dhe u jep mundësi të gjithë OE Ofertues edhe në ato rastet kur Formularët e Vlerësimit mund të jene të paplotesuara sipas standartit.*

**2.3.2** Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, leshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Keshillit të Ministrave Nr.42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

#### **Punime të Përgjithshme Ndërtimi**

- NP.1 A Punime gërmimi në tokë;
- NP.4 A Rruge, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale;
- NP.7 B Ujesjelles , Vajesjelles, vepra kullimi e vaditje etj;
- NP.12 B Punime të inxhinierisë së mjedisit;

#### **Punime Speciale Ndërtimi:**

- N.S 18 A Punime topogjeodezike.

Operatorët e huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturas dhe Energjisë, (ose Ministrise kompetente te kohes) Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te subjekteve juridike qe ushtrojne veprimtari ndertimi, e miratuar me VKM- ne, Nr. 42, date 16.01.2008).

**Mosparaqitja ne kete forme eshte kusht skualifikues.**

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” te ndryshuar, si dhe të ligjit nr.10081, datë 23.2.2009, "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 18, të ligjit nr.8402, datë 10.9.1998, "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", të ndryshuar si edhe Vendimin nr. 42, date 16.01.2008 "Per miratimin e rregullores per kriteret dhe procedurat e dhenies se licencave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te subjekteve juridike, qe ushtrojne veprimtari ndertimi", pikat e licences dhe kategorite me klasifikimet perkatese caktohen duke u mbeshtetur ne punimet e parashikuara ne preventivin e objektit dhe ne vleren totale te punimeve per secilen kategori.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente.

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

Kategoria e kërkuar	Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive	Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
N.P – 1 A	Punime Germimi	Percaktimet ne preventiv	A	Nuk e kalon vleren 20 milion leke.
N.P - 4 A	Rruge , ura	Percaktimet ne preventiv	A	Nuk e kalon vleren 20 milion leke.
N.P – 7 B	(Ujesjelles , Vajesjelles, vepra kullimi e vaditje etj).	Percaktimet ne preventiv	B	E kalon vleren 20 milion leke.
N.P – 12 B	(Punime të inxhinierisë së mjedisit).	Percaktimet ne preventiv	B	E kalon vleren 20 milion leke.
N.S – 18 A	- (Punime topogjeod ezike).	Percaktimet ne preventive	A	Nuk e kalon vleren 20 milion leke

**2.3.3** Referuar preventivit, grafikut, specifikimeve teknike si dhe punimeve ndertimore,Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor, drejtues teknik** në licencën e shoqërisë,si më poshtë:



- 1(nje) Inxhinier Ndërtimi Profili Gjeoteknik
- 1(nje) Inxhinier Gjeodet
- 1(nje) Inxhinier Mjedisi
- 1(nje) Inxhinier Hidroteknik
- 1 (nje) Inxhinier Mekanik

Për secilin nga drejtuesit teknike si me sipër te paraqitet:

- a) Kontrate pune;
- b) Diplome;
- c) Libreze pune;
- d) CV;

Drejtuesit teknik duhet të jenë të punësuar sipas kritereve të VKM nr. 42 date 16.01.2008, i ndryshuar, sa i takon ndalimeve të dypunësimit. Per kete arsye te paraqitet deklarate perkatese nga Administratori i shoqerise. Operatorët ekonomik duhet të caktojë me anë të një dekaratë Drejtuesin Teknik të punimeve i cili duhet të jetë i përfshirë në license e shoqërisë dhe të deklarojë se ai nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt.

***Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojces Nr.8, të DST-ve dhe në zbatim të V.K.M-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, neni 26 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit”, pika 6 “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”, si më sipër kërkuar.***

***Argumentimi:*** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenit 39, pika 6/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik“, te ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë nje liste personeli kryesor të nevojshme për te zbatuar objektin e prokurimit dhe /ose komponentet e saj, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar stafin teknik të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, konkretisht sipas VKM nr. 629, date 15.07.2015 “Per miratimin e manualit teknik te cmimeve te punimeve te ndertimit dhe te analizave teknike te tyre” bazuar ne perlllogaritjen e oreve te punes, kategorite e punimeve te percaktuara ne preventive, specifikimet teknike te objektit, detajeve te projektit dhe tipologjia e zerave te punimeve, te cilat lidhen ngushtesisht me listen e stafit teknik te kerkuar nga AK, si edhe bazuar ne dosmosdoshmerine e realizimit sa me shpejt te objektit.

Lidhur me kërkesën që Drejtuesi Teknik i punimeve në objekt duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë mbështetet në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, pika 2 ku përcaktohet se: “Papajtueshmëritë me detyrën e drejtuesit teknik të shoqërisë së zbatimit Drejtuesit teknikë të shoqërisë nuk mund të jenë personat që janë të angazhuar në çdo punë-marrje tjetër publike. Drejtuesi teknik i shoqërisë nuk mund të jetë njëkohësisht i punësuar

në dy apo më shumë shoqëri ndërtimi dhe ndalohe të disponojnë licencë për mbikëqyrje e kolaudim të punimeve të zbatimit” dhe pika 2: “elementët e licensës” gërma “c” ku citohet se: “Licencat e shoqërive jepen me afat të njëjtë me atë për të cilin janë regjistruar për të ushtruar veprimtari në QKB apo gjykatë. Ndalohe ushtrimi i veprimtarisë zbatuese në ndërtim në mungesë të drejtuesit/ve teknikë të shoqërisë. Shoqëritë e licencuara jo më vonë se 10 ditë kalendarike, kur drejtuesi teknik është dorëhequr ose ka pamundësi fizike për ushtrimin e detyrës (aksident, sëmundje me paaftësi ushtrimi detyre mbi 14 ditë, invaliditet, ndarje nga jeta), kanë detyrimin të paraqesin njoftim së bashku me kërkesën për drejtuesin e ri teknik të shoqërisë”.

Për sa më lart, çdo kërkesë e renditur për Drejtuesin Teknik, buron nga kontrata e punës objekt prokurimi, me qëllim përmbushjen dhe realizimin e saj sipas kushteve dhe dipozitave ligjore në fuqi.

**Është kërkuar inxhinier ndërtimi gjeoteknik** i cili është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet, për secilin nga zërat e punimeve ndërtimore, referuar preventivave të punimeve, kontrollit të punimeve të betonit të pranishme në preventiv si: ndërtim mure betoni, ndertim rruge, germime.etj

**Është kërkuar inxhinier hidroteknik** i cili është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve voluminoze hidraulike lidhur me zërat e preventivave të punimeve seksioni “Punime hidroteknike”, kontrollin e gjithë punimeve që kanë lidhje ndertimin e kanalit vadites.

**Është kërkuar gjeodet/topograf**, pasi sipas relacionit teknik dhe specifikimeve teknike, është parashikuar se kontraktori që do të marrë përsipër zbatimin e objektit inxhinierik, duhet të bëjë dendësimin e pikave të bazamentit, duke realizuar vlerat e paracaktuara të dhëna në specifikimet teknike të objektit, në lidhje me saktësinë e realizimit të piketimit. Nga shoqëria kërkohet dhe një azhornim i saktë i këtij investimi në përfundim.

**Është kërkuar inxhinier mjedisi**, pasi ai është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që do të ndërtohet për secilin nga zërat e punimeve të mjedisit. Zbatimi i projektit nuk duhet të ketë pasoja negative në mjedisin e zonës. Të bëhet monitorimi periodik i emetimit të zhurmave në mjedis dhe gazrave në ajër, për kanalet e drenazhimit të ujërave, rreth perimetrin të zonës së punimeve.

**Është kërkuar inxhinier mekanik**, pasi ai është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që do të ndërtohet për secilin nga zërat e punimeve, kryesisht punime mekanike, porta barazhi, porta prizash, sifone etj.

**2.3.4 Operatori ekonomik,për realizimin e punimeve objekt kontrate,duhet të disponojë edhe Stafin mbështetës si më poshtë:**

- 1(një) Inxhinier ndertimi
- 1(një) Teknik ndërtimi
- 6 (Gjashte) Karpentier
- 5(pese) Hekurkthyes
- 2 (dy) Hidraulike
- 3 (tre) Betonues
- 3 (tre) Murator

- 1(nje) Mekanik
- 2 (dy) Saldator
- 1 (nje) Pergatites te konstruksioneve metalike

Per punojesit e mesiperm duhet te paraqiten:

- Kontratat e punës individuale (të vlefshme).
- Certifikata/diploma për formimin profesional (të vlefshme), të cilat duhet të jenë të lëshuara nga institucione publike/ private të licensuara sipas ligjit Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në R.Sh.”, i ndryshuar.
- Te gjithë punojësit e mësipërm duhet të figurojnë në listepagesat të shoqërisë minimalisht për periudhën 3 (tre) muajt e fundit nga data e hapjes së procedurës.
- Per Teknikun e Ndertimit, duhet te paraqitet deftese e shkolles se mesme.
- Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B, operatorët ekonomik duhet të deklarojnë për punonjësit e mesiperm, emer/mbiemer, profili i punes, numri dhe datë e kontratës individuale të punës, numri dhe titulli i kualifikimit për diplomën/certifikatën përkatëse si dhe emrin e institucionit që ka lëshuar dokumentin për specialistet e kualifikuar me siper.

***Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës Nr.8, të DST-ve dhe në zbatim të V.K.M-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, neni 26 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit”, pika 6 “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”, si më sipër kërkuar.***

***Argumentimi:*** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenit 39, pika 6/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, te ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë një liste personeli kryesor të nevojshme për të zbatuar objektin e prokurimit dhe /ose komponentet e saj, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

*Kërkesa specifike për Stafin teknik është përcaktuar në kuadër të analizës teknike që i është bërë Preventivit të Punimeve në bashkërendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë (kapaciteti teknik në DST) si dhe në përputhje me Stafin inxhinierik të kërkuar (kapaciteti teknik në DST). Stafin teknik (në bashkëpunim me stafin inxhinierik, si dhe fuqinë tjetër punëtore) do jetë përgjegjës për të ekzekutuar kontratën objekt prokurimi në zbatim të plotë me Projektin e zbatimit si dhe brenda afatit të parashikuar në Njoftimin e Kontratës.*

*Për sa më lart, gjykohet e arsyeshme që Ofertuesit duhet të kenë staf teknik sipas pikës 2.3.4, i cili do të garantojë zbatimin e punimeve sipas Specifikimeve teknike dhe do jetë përgjegjës për realizimin e zërave të Preventivit.*

*Për të vërtetuar kualifikimin e stafit teknik është kërkuar që të jenë të pajisur me dëshmi kualifikimi profesional lëshuar nga institucione të akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik, (të vlefshme) lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik. Kërkesa për stafin teknik është mbështetur gjithashtu në “Rregulloren e sigurimit dhe shfrytëzimit teknik për impiantet, pajisjet dhe instalimet elektrike” ku janë përcaktuar edhe kategoritë e dëshmimeve të kualifikimit të sigurimit teknik.*

*Ne lidhje me 1 (nje) inxhinier ndertimi* prezenca e tij në kantieret e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve të punës që do të realizohen në baze të analizës teknike. Bazuar në zërat e preventivit të punimeve, specifikimeve teknike, prezenca e inxhinierit të ndërtimit është gjykuar si e domosdoshme. Kërkohet ky inxhinier për të ardhur në ndihmë stafit teknik meqenëse kanali është i shpërndarë dhe do punohet në disa kanale njëkohësisht.

*Ne lidhje me 1 (nje) punonjes Teknik ndertimi* prezenca e tij në kantieret e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve të punës që do të realizohen në baze të analizës teknike. Tekniku i ndërtimit është implementuesi kryesor i rekomandimeve dhe udhëzimeve të inxhinierit të ndërtimit për sa i përket punimeve ndërtimore.

*Ne lidhje me 6(gjashte) punonjes Karpentier* kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve të punës që do të realizohen. Karpentieret duhen për realizimin e punimeve të betonit në veshje në kanale.

*Ne lidhje me 5 (pese) punonjes hekurkthyes* kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve të punës që do të realizohen në baze të analizës teknike, kryesisht punime vendosje e lidhje hekuri.

*Ne lidhje me 2 (dy) punonjes Hidraulik* kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve të punës që do të realizohen.

*Ne lidhje me 3 (tre) punonjes Betonues* kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve të punës që do të realizohen për betonimet.

*Ne lidhje me 3 (tre) punonjes Murator* kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve të punës që do të realizohen në baze të analizës teknike, për realizimin e punimeve të ndërtimit të mureve neper ura kalimi në kanale

*Ne lidhje me 1(nje) punonjes Mekanik* kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve të punës që do të realizohen. Mekaniku është kërkuar nga autoriteti kontraktor për mirëmbajtjen e mjeteve të kërkuara.

*Ne lidhje me 2 (dy) punonjes Saldator* kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve të punës që do të realizohen në baze të analizës teknike, për realizimin e saldimeve të portave të kanalit.

*Ne lidhje me 1(nje) punonjes Pergatites te konstruksioneve metalike* kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve të punës që do të realizohen në baze të analizës teknike, kryesisht punime porta e priza dhe sifon metalik.

**2.3.5** Operatori ekonomik,për realizimin e punimeve objekt kontrate,duhet të disponojë edhe stafin mbështetës si më poshtë:

- a. Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë 1 (një) punonjës specialist që të disponojë certifikatë e trajnimit si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë" në përputhje me klauzola të ligjit Nr.10327, datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier".
- b. Operatori ekonomik të ketë në stafin e tij 1 (një) punonjës të pajisur me certifikatë "Ekspert për ndihmën e parë dhe nderhyrjen ndaj emergjencave", e cila të jetë e leshuar nga shoqëria të akredituara nga DPA ose nga organizmat

nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise.

- c. Operatorët ekonomik të kenë në stafin e tyre minimumi 1(një) punonjës të pajisur me çertifikatë “Përgjegjës për dëmet në mjedis”, në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10431, datë 09.06.2011“Për mbrojtje se mjedisit”,i ndryshuar. Për këtë duhet të paraqitet çertifikata e trajnimit e dhënë nga një organizem i licensuar, shqiptar ose i huaj.

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri,operatorët ekonomikë duhet të paraqesë:

- a) Kontrate pune;
- b) diplome/ certificate;
- c) te figurojone listpagesat për 3 (tre) Muajt e fundit

***Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojces Nr. 8, të DST-ve dhe në zbatim të V.K.M – së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, neni 26 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit”, pika 6 “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar,i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”, si më sipër kërkuar.***

***Argumentimi:*** Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret e tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës. Kërkesa e mësipërme mbështetet në ligjin Nr. 10327 datë 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe VKM nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores Për sigurinë në kantier”. Natyra e kontratës dhe specifikat e saj kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM Nr. 312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ndjekë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënës zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmën e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë, për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes.

***AK argumenton se kërkesa për 1 (nje) Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit në punë është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4; të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”, si dhe në mbështetje të Nenit 7 të Ligjit Nr. 10237, datë 18.02.2010 „Për sigurinë dhe shëndetin në punë“, sipas të cilit: „Punëdhënësi ngarkon një ose disa punëmarës që të merren me çështjet e mbrojtjes, të sigurisë e shëndetit në punë.....“.***

***Theksojmë se, Autoriteti Kontraktor ka qëllim realizimin e kontratës objekt prokurimi sipas kushteve të përcaktuara në DST, duke respektuar çdo rregull lidhur me kantierin e ndërtimit si dhe me sigurinë e punonjësve gjatë ushtrimit të veprimtarisë së punës. Është e rëndësishme që punimet të realizohen brenda një kantieri të sigurt duke mbrojtur jetën e punonjësve. Për sa më lart, punonjësit te cilet janë te çertifikuar si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit në***

*punë”, nëpërmjet dijës dhe eksperiencës të fituar në këtë fushë, duhet të shmangin apo parandalojnë çdo rrezik që mund të shfaqet gjatë veprimtarisë së shoqërisë dhe që mund të çënojë shëndetin apo sigurinë në punë. Në këto kushte, vendosja e këtij kriteri shërben si një garanci që Ofertuesit do të realizojnë punimet sipas standarteve ligjore në fuqi.*

*AK argumenton se kërkesa për 1 (një) punonjes të pajisur me çertifikatë “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave”, është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4; të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”, si dhe në mbështetje të Nenit 8 të Ligjit Nr. 10237, datë 18.02.2010 „Për sigurinë dhe shëndetin në punë“, sipas të cilit: „Punëdhënësi: merr masa paraprake për të organizuar dhënien e ndihmës së parë, mbrojtjen ngazjarri dhe evakuimin në rastet kur ka rrezik për të ndodhur ngjarje...*

*AK argumenton se kërkesa për 1 (një) punonjes të pajisur me çertifikatë “Përgjegjës për dëmet në mjedis” është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4; të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”, si dhe në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10431, datë 09.06.2011 “Për mbrojtje se mjedisit”, i ndryshuar.*

**2.3.6** Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar te pakten 4 (kater) Shofere dhe 6 (gjashte) Manovrator (2 automakiniste, 3 eskavatoriste dhe 1 buldozerist). Per punonjesit shofere dhe manovratorë të mjeteve të rënda duhet të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë për 3 (tre) muajte e fundit dhe te paraqiten deshmit e aftësisë profesionale dhe leje drejtimi sipas rastit, të lëshuara nga D.P.SH.T Rrugore.

**Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojces Nr. 8, të DST-ve dhe në zbatim të V.K.M – së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, neni 26 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit”, pika 6 “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”, si më sipër kërkuar.**

**Argumentimi:** Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret e tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës. Në lidhje me Manovratorët dhe Shoferat kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve të punës që do të realizohen, duke u bazuar dhe në listën e mjeteve të kerkuara për këtë procedurë, kërkesa e mësipërme është një kërkesë minimale.

Njësia e Prokurimit duke marrë në konsideratë natyrën e punimeve; makineritë që do të kërkojnë për realizimin e punimeve si dhe Preventivin e Punimeve shtrën nevojën që Ofertuesit të kenë të punësuar 6 Manovrator dhe 4 shofer me qëllim realizimin e kontratës me sukses. Numri i këtyre punonjësve është përcaktuar duke marrë në konsideratë volumet e punimeve për

secilin zë pune mbështetur kjo në VKM Nr. 629 datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizat teknike të tyre”.

Manovratorët janë të nevojshme për levizjen dhe punimin e mjeteve si eskavator, pompa betoni, dumbëra etj.

Shoferët janë të nevojshme për ngarjen e mjeteve si kamioncina, kamiona etj.

**2.3.7** Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore **minimalisht 40 (dyzet) persona**. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve për 3 (tre) muajt e fundit, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojces 8.

Operatori ekonomik krahas deklaratës, duhet të dorëzojë dokumentacionin si me poshtë:

- Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj;
- Listë pagesat e punonjësve, të konfirmuara nga institucionet përkatëse sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi.

**Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojces Nr. 8, të DST-ve dhe në zbatim të V.K.M – së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, neni 26 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit”, pika 6 “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”, si më sipër kërkuar.**

**Argumentim:** Ky kriter është vendosur në bazë të pikës 4, nenit 77, të ligjit nr 162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik “ dhe nenit 39, Pika 6/ç, të VKM nr 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar , me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomik të deshmohen që kanë fuqi minimale puntore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Autoriteti kontraktor në përcaktimin e fuqisë puntore të nevojshme për realizimin e kontratës ka bërë një përllogaritje të saktë të numrit të punonjësve duke përcaktuar fillimisht orët e punës në bazë të analizës sipas manualit teknik të çmimeve të ndërtimit miratuar me VKM Nr 216 Datë: 13.04.2023” PËR KRIJIMIN DHE FUNKSIONIMIN E SISTEMIT TË INTEGRUAR PËR INFORMATIZIMIN E MANUALIT TË ÇMIMEVE PËR ZËRAT E PUNIMEVE NË NDËRTIM Në këtë kontekst ,autoriteti kontraktor ka përcaktuar numrin e punonjësve referuar një përllogaritje të saktë të bërë referuar zërave të punimeve për objektin e prokurimit orëve të punës ( 8 orë në ditë për çdo punonjës) afatit kohor të realizimit të kontratës si dhe shpërndarjes së punës. Në numrin e përcaktuar për fuqinë puntore janë përllogaritur stafit teknik dhe inxhinjerik si dhe stafit administrativ. Nga përllogaritja e orëve të punës për çdo zë pune rezulton se për kryerjen e punimeve sipas grafikut të punimeve duhet 40 (dyzet )punonjës.

#### DETAJIMI I OREVE TE PUNES

NR	KODI	EMËRTIMI I PUNIMEVE	NJËSIA	SASIA	ORE PUNE	ORE PUNE TOTAL	DITE PUNE
		<b>1. PUNIME GERMIMI</b>					

1	3.90/a	Germim dheu me ekskavator goma 0.25 m <sup>3</sup> , ne kanale gjeresi deri 2 m, prani uji, kategoria III, me shk ne mjet	m3	2900.0	0.12	348	43.5
2	3.48/b	Rrafshim skarpatesh, me krahe, ne germim toke te zakonshme	m2	5500.0	0.45	2475	309.375
		<b>2. PUNIME SHPYLLEZIMI</b>				0	0
3	3.2	Prerje bime te vogla $\phi \sim 10\text{cm}$	m2	5513.0	0.08	441.04	55.13
		<b>3. NDERTIMI I VEPRAVE TE ARTIT+KANALIZIME</b>				0	0
4	3.597	Pastrim tombino	m3	20.0	4.5	90	11.25
5	3.365	Tombino me tuba betoni $\phi 600$ , mbi shtrese betoni	m	12.0	4.4	52.8	6.6
		<b>4. PUNIME SHTRESASH 2</b>				0	0
6	2.262/3	Shtrese betoni C 12/15	m3	1492.0	10.5	15666	1958.25
		<b>5. PUNIME HEKUR BETONI 3</b>				0	0
7	3.287	F V hekur betoni i zakonshem $\phi 6 \sim 10\text{mm}$	ton	42.0	61	2562	320.25
8	3.294	F V detaje metalike ne b/a	ton	1.0	39	39	4.875
		<b>6. PUNIME SHTRESASH</b>				0	0
9	3.210	Shtrese çakelli mbeturine kave t=15cm, perhapur e ngjeshur me makineri	m2	9042.0	0.21	1898.82	237.3525
		<b>7. PUNIME DHEU</b>				0	0
10	2.37/5a	Transport materiale ndertimi, dheu me auto deri 5.0 km	m3	2900.0	0.17	493	61.625
		<b>8. PUNIME BETONI DHE B/A</b>				0	0
11	2,129	Mure b/a t = 11-20cm h ~ 4m C 16/20	m3	14.0	13.3	186.2	23.275
<b>SHUMA</b>							<b>3031.5</b>
<b>Afati i realizimit sipas grafikut 6 muaj (132 dit pune)</b>							<b>132</b>
<b>Numri total i puntoreve</b>							<b>23</b>
<b>Staf teknik (drejtues teknik 5 + inxhinier teknik 2 + manovrator shofer 10)</b>							<b>17</b>
<b>Totali nr. Punonjesve</b>							<b>40</b>

**2.3.8** Operatori ekonomik duhet të vërtetojë se e zhvillon aktivitetin e tij në fushën objekt prokurimi në përputhje me standardet e menaxhimit të cilësisë, të shëndetit e sigurisë në punë, mjedisit dhe menaxhimit te energjise. Për këtë duhet të paraqesë çertifikatat e mëposhtme:

- ISO 9001:2015 “Per Sistemin e menaxhimit te cilesise”, e vlefshme, ose ekuivalente;
- OHSAS 18001:2007 mbi “Per Sistemin e menaxhimit te Shendetit dhe sigurise ne pune”, e vlefshme, ose ISO 45001:2018 ose ekuivalente;
- ISO 14001:2015 mbi “ Per Sistemin e menaxhimit te mjedisit”, e vlefshme, ose ekuivalente;
- ISO 39001:2012 mbi “Per Sistemin e menaxhimit te sigurisë”, e vlefshme, ose ekuivalente.

Çertifikatat duhet të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit dhe gjatë periudhës së



parashikuar për zbatimin e kontratës.

Ne rastet e Bashkimit të operatoreve ekonomik Certifikatat përmbushen në baze të punëve që marrin perspektivë secili prej operatoreve.

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77 pika 1/a dhe 2 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, në të cilët përcaktohet: “Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë, bazuar në: aftësinë teknike dhe profesionale; Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore, mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie”

Në nenin 44 “Kërkesat e cilësisë” të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 përcaktohet: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit, ose nga organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.”

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se plotësojnë standartet e kërkuara të cilësisë, standartet për shëndetin dhe sigurinë në punë, si dhe standartet e menaxhimit të mjedisit. Në mbështetje të përcaktimeve ligjore dhe nënligjore të sipërcituara, autoriteti kontraktor vlerëson se: Autoriteti kontraktor gjykon se operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duhet të plotësojnë kërkesat e standarteve në lidhje me garantimin e cilësisë së punimeve objekt kontrate, në mënyrë të qëndrueshme, ku referuar natyrës së punimeve që kërkohen të kryhen, njësia e prokurimit ka kërkuar certifikatat e mësipërme për vërtetimin se operatorët ekonomikë i plotësojnë kërkesat e cilësisë për këto punime. Njësia e prokurimit përcaktoi kriteret si më lart duke qenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës. Por edhe sepse mbi të gjitha ato i shërbejnë autoritetit tonë kontraktor për njohjen e aftësisë profesionale, organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre, për përmbushjen me sukses të kontratës.

**Certifikatë ISO 9001 - 2015** “Për Sistemin e menaxhimit të cilësisë”, mundëson që shoqëria të punojë me standarde të cilësisë e cila mundëson implikimin në menaxhim, identifikimin e riskut dhe mundësitë, sigurimin e konkurrencës për personelin e shoqërisë, mirëmbajtja e pajisjeve dhe infrastrukturës, etj.

ISO 9001 - 2015 është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit të cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërrmarjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërrmarje duhet t’i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërrmarjes në standartet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001:2015 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky çertifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.

**Certifikatë ISO 45001-2018** “Për sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurimit në punë”, mundëson që çdo kompani duhet të mbrojë shëndetin dhe sigurinë në punë për të gjithë punonjësit, e cila përfshin vlerësimin e rreziqeve të aksidenteve në punë, vendosjen e masave në fushën e shëndetit dhe sigurisë, inkurajimin e pjesëmarrjes së punonjësve në përpjekjet për të

përmirësuar kushtet e punës, zbatimin e masave për të zvogëluar rreziqet e aksidenteve dhe sëmundjeve si dhe hetimin e incidenteve.

*ISO 45001-2018 është standard ndërkombëtar, i cili parashtron kërkesat për menaxhimin e praktikave të mira të sigurisë dhe shëndetit në punë për çdo organizatë, pavarësisht nga madhësia. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 45001-2018 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci extra që do të sjellë reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e punës duke minimizuar kostot si dhe kohën në përmbushje me sukses të kontratës së punës objekt prokurimi.*

**Certifikatë ISO 14001:2015** është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit mjedisor, me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e menaxhimit mjedisor.

**Certifikatë ISO 39001:2012** mbi "Sistemet e menaxhimit të sigurisë" është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit të sigurisë me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e menaxhimit të sigurisë.

**2.3.9** Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me license lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit për grumbullim dhe transportim të mbetjeve që kanë ndikim në mjedis, Kodi III.2.B, shoqeruar me aktin e miratimit.

**Argumentimi:** Keto Licenca janë të nevojshme për hartimin e ekspertizave të ndryshme, si dhe për grumbullimin dhe transportimin e mbetjeve pasi qyteti nuk ka landfill. Ky kriter është vendosur në baze të pikës nenit 77, të ligjit nr 162 datë 23.12.200 "Per Prokurimin Publik" dhe nenit 39, Pika 8 të VKM nr 285, datë 19.05.2021 "Per miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar ,

**2.3.10** Operatori ekonomik duhet të ketë kontratë noteriale me një laborator testimi të betonit, i cili duhet të jetë i akredituar nga organizma kombëtar ose ndërkombëtar sipas standarteve. Detyrimisht të paraqitet kontrata noteriale.

**Argumentimi:** Kjo kontratë është e nevojshme pasi betonet janë zërat e punimeve të cilët kanë mbi 50% të vëllimeve dhe vlerës së punimeve dhe është kërkuar për sigurinë e cilesisë dhe furnizimit në kohë të objektit që prokurohet.

**2.3.11** Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Mjetet	Sasia	Gjendja
Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës mbi 20 ton)	2 copë	Në pronësi ose me qera
Kamion me vinç	1 copë	Në pronësi ose me qera
Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 10- 12 ton	2 copë	Në pronësi ose me qera
Kamionçine me kapacitet mbajtës 3.5-5 ton	2 copë	Në pronësi ose me qera
Eskavator me goma (mjet teknologjik me goma)	2 copë	Në pronësi ose me qera

Autobot uji	1 copë	Në pronësi ose me qera
Fadrome me goma (mjet teknologjik me goma)	1 copë	Në pronësi ose me qera
Autobetoniere	4 copë	Në pronësi ose me qera
Autopompe betoni	2 copë	Në pronësi ose me qera
Minifadrome	1 copë	Në pronësi ose me qera
Minieskavator me peshe 3-5 ton	1 copë	Në pronësi ose me qera
Rrul hekur-gome me kapacitet 5 -8 ton	1 copë	Në pronësi ose me qera
Rrul hekur-gome me pashe mbi 15 ton	1 copë	Në pronësi ose me qera
Vibrator Betoni	1 copë	Në pronësi ose me qera
Autobetoniere me kapacitet 2.5-3 m3(mjet teknologjik me goma)	1 copë	Në pronësi ose me qera
Rimorkiator	1 copë	Në pronësi ose me qera
Koke terheqese	1 copë	Në pronësi ose me qera
Greider (mjet teknologjik me goma)	1 copë	Në pronësi ose me qera
Tranxhe për perpunimin e hekurit te ndertimit	1 copë	Në pronësi ose me qera
Nyje prodhim Inertesh e pajisur me QKL	1 copë	Në Pronësi /me qera/ Kontrate furnizimi noteriale.
Linje Prodhimi Betoni me QKL	1 copë	Në Pronësi/ me qera/ Kontrate furnizimi noteriale
Dumper (mjet teknologjik me goma)	2 copë	Në pronësi ose me qera
Saldatrice	2 copë	Në pronësi ose me qera
Gjenerator mbi 50 kva	1 copë	Në pronësi ose me qera
Aparat topogjeodezik me GPS	1 copë	Në pronësi ose me qera

Për mjetet që regjistrohen ne regjistra publike duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, Çertifikaten e pronesise, Çertifikatë për transport mallrash për llogari të vetë (vetem mjetet e transportit) dhe siguracionin e mjetit (te vlefshme), dhe per mjetet e siguruara me qera, dokumentete mesiperme duhet te shoqerohen me kontraten noteriale perkatese te qerese, e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates objekt i ketij prokurimi.

Per mjetet e transportit me qera te paraqitet gjithashtu Çertifikatë për transport mallrash. Në rastin e mjeteve te tjera duhet te paraqiten akte te çdoganimit ose faturat tatimore te blerjes.

Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, kur jane ne pronesi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes apo çdoganimit, fatura tatimore perkatese fotot dhe fatura tatimore perkatese, ndersa per mjete te marra me qira krahas dokumentacionit te mesiperm, duhet te paraqitet edhe kontrata e qirase e cila duhet te perfshije objektin perkates dhe duhet te jete e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te punimeve deri ne perfundimin e plote te punimeve.

Për mjetet dhe pajisjet që nuk shënohen në regjistra publik duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre, apo marrjen me qira te tij.

Operatori/Operatori/et ekonomik ofertues duhet te deklarroje qe te gjitha mjetet dhe pajisjet e pershkruara do te angazhohen ne kete objekt prokurimi. Autoriteti Kontraktor gezon te drejten te verifikojte dhe kontrolloje disponueshmerine e ketyre mjeteve si gjate vleresimit te ofertave ashtu edhe gjate zbatimit te kontrates.

*Autoriteti Kontraktor ka te drejte te kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik".*

**Argumentimi:** *Këto mjete dhe pajisje referuar preventivit të punimeve janë të nevojshme për realizimin e punimeve, ndaj njësia e prokurimit vendosi që të kërkojë që operatorët ekonomike të disponojnë mjetet dhe pajisjet e mësipërme sepse ato nevojiten për kryerjen e punimeve dhe janë në përpjesëtim me objektin e kontratës.*

*Për të përcaktuar llojin dhe numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë bazuar sipas zërave te preventivit dhe specifikimeve teknike te hartuara nga specialistet e fushës. Çdo mjeti kërkuar përkon me proceset ndërtimore sipas zërave përkatës të preventivit. Numri i makinerive është përcaktuar duke marrë në konsideratë volumet e punimeve për secilin zë pune mbështetur kjo në VKM Nr. 629 datë 15.07.2015 "Për miratimin e manualeve të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizat teknike të tyre". Dokumentacioni shoqëruet i kërkuar për makineritë, provon certifikimin ligjor dhe teknik të mjeteve të disponuara nëpërmjet kontratës së shitjes apo kontratës së qirasë. Ky dokumentacion i jep garanci autoritetit kontraktor se punimet do të realizohen me cilësi, siguri dhe në respektim të grafikut të punimeve. Në mbështetje të dispozitës ligjore të sipërcituar Ligjvënësi i jep të drejtën Autoritetit Kontraktor të kërkojë nga ana e Operatorëve ekonomike dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike. Njësia e Prokurimit ka vlerësuar si të domosdoshëm paraqitjen e deklaratave dhe dokumentacionit përkatës ne lidhje me mjetet dhe pajisjet teknike që Operatori ekonomik disponon në funksion të realizimit të kontratës objekt prokurimi. Çdo mjet i përcaktuar në procedurën e prokurimit është kërkuar në funksion të kryerjes së zërave specifike të punimeve, ndërsa numri i mjeteve është përcaktuar në varësi të volumeve të punimeve dhe kohës së realizimit të tyre. Përsa më sipër, numri i mjeteve është përcaktuar në bazë të nevojës pasi objekti zhvillohet në një kohë të shkurtër, pa cenuar grafikun e përcaktuar të punimeve dhe, veç të tjerash, objekti ka një shtrirje të konsiderueshme gjeografike, prandaj do të punohet në disa fronte pune njëkohësisht, për të kapur afatet e përcaktuara. Në lidhje me kriterin për disponimin e makinerive dhe pajisjeve, njësia e prokurimit vlerëson se referuar përmasave dhe volumit të punimeve objekt kontrate, operatorëve ekonomike u lind e nevojshme disponimi i makineri pajisjeve.*

*Sqarim lidhur me kerkesen e mjeteve te mesiperme:*

- 1) Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 20 ton, eshte i nevojshem per transportimin e materiale te krijuara nga prishjagermimi dhe materialet e mbushjes .*

- 2) Kamion me Vinc, i nevojshme per ngritjen me efikasitet te materialeve, veglave etj ne lartesi dhe levizjen e materialeve te renda ne plan per te rritur rendimentin e punes.
- 3) Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 10-12 ton, ky mjet vjen ne ndihme te kamionit me kap mbajtes mbi 20 ton ne menyre qe sheshi te aksesohet nga disa drejtime per te ruajtur, ndikimin ne mjedis nen normat e lejuara gjate punimeve te prishjes, transportit etj
- 4) Kamioncine me kapacitet mbajtës 3-5 ton, ky mjet perdoret per materialet me pesha specifike me te vogel se materialet e prishjes (kryesisht betone strukturore, tombino, hekur), gjithshu jane te domosdoshem per aksesin e tyre ne gjeresi te kufizuara ne sheshin e ndertimit
- 5) Eskavator me goma , i nevojshme per germimet e ndryshme per kanalim, per ndertimin e rruges, per punimet e germimit te muri etj...
- 6) Autobot uji, eshte i nevojshem per furnizimin me uje te kantierit gjate punimeve te ndryshme shkarkimet etj.
- 7) Fadrome me Goma nevojshem per germim dhe per shtytjen e materialeve te ndryshme te dale nga punimet e prishjes dhe punimet e germimit, per afrimin e materialeve ne kabtier etj..
- 8) Autobetonierë, ky mjet eshte i nevojshem per punimet e betonit te armuar ne nevojshmeri per te kryer procesin e betonimit te panderprere per nje cilesi minimalisht te pranueshme sipas kushteve teknike te zbatimit.
- 9) Autopompe betoni, ky mjet sherben per hedhjen e betonit nga autobetonierja ne elementin strukturor ose jo te pergatitur per betonim.
- 10) Minifadroma, i nevojshme per realizimin e levizjes se materialve te te germimit ne zona te ngushta aksesi ne sheshin e ndertimit dhe per ngarkimin e tyre ne mjetet e transportit.
- 11) Minieskavator me peshe 3-5 ton, i nevojshme per realizimin e levizjes se materialve te te germimit ne zona te ngushta aksesi ne sheshin e ndertimit dhe per ngarkimin e tyre ne mjetet e transportit.
- 12) Rrul hekur-gome m ekapacitet 5-8 ton, Rrul hekur-gome me peshe mbi 15 ton jane te nevojshem per ngjeshjen e shtresave rrugore.
- 13) Vibrator Betoni per vibrimin e betonit.
- 14) Autobetoniere me kapacitet 2.5-3 m<sup>3</sup>(mjet teknologjik me goma) per betonet me sasi te vogla ne kantierin e ndertimit.
- 15) Rimorkiator, Koke terheqese per transportin e te gjitha mjeteve te renda si grejder eskavatore rula minieskavator, fadrome etj...
- 16) Greider (mjet teknologjik me goma) per hapjen e shtresave te rruges ne krah te kanalit vadites.
- 17) Tranxhe për perpunimin e hekurit tendertimit per kthimin dhe prerjen e hekurit ne objekt sipas projektit te zbatimit.
- 18) Nyje prodhim Inertesh e pajisur me QKL per garantimin dhe furnizimin ne kohe me materialin e cakullit dhe stabilizantit.
- 19) Linje Prodhimi Betoni me QKL per garantimin dhe furnizimin ne kohe me materialine e betonit.

- 20) Dumper(mjet teknologjik me goma) per spostimin e inerteve dhe materialeve te ndryshme ne kantier.
- 21) Saldatrice per saldime te ndryshme te konstruksionit sipas projektit ne kantierin e ndertimit.
- 22) Gjenerator mbi 50 kva per furnizimin me energji te kantierit.
- 23) Aparat topogjeodezik me GPS mjet qe i nevojitet inxhinerit te topograf per piketimin e kanalit dhe rruge sipas projektit.

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik".

**Ju lutemi sigurohuni që:**

- Secili pjesëmarrës i renditur në një bashkim operatorësh ekonomikë të paraqesë një Formular të veçantë të Vetëdeklarimit.
- Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, një Formular i veçantë i Vetëdeklarimit duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.
- Çdo vetdeklarim i pavërtetë/pasaktë nga ana e operatorëve ekonomikë jo vetëm që përbën shkak për skualifikimin nga procedura konkrete, por përbën shkak edhe për përjashtimin e tyre nga e drejta për të fituar kontrata publike deri në 3 vjet, sipas parashikimeve të ligjit për prokurimin publik.
- Operatorët ekonomikë që ofertojnë në procedurat e prokurimit të vetdeklarojnë në çdo rast informacionin e saktë që i korrespondon gjendjes së tyre faktike.
- Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.
- Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

## **NJËSIA E PROKURIMIT**